



V E N D I M

Nr.112 Date 16.09. 2008

**PER
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PER LIÇENSIMIN E SHOQERISE
“GEN –I TIRANA SH.P.K PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 45 pikat 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 gërma d, dhe 10, të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe nenit 18 pikat 1 gërma a, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.09.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GEN –I TIRANA” sh.p.k, për tu liçensuar në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi:

1. Paraqitjen e plotë të dokumentacionit sipas Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, nga shoqëria GEN –I TIRANA më datë 04.09.2008 për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Rregullorja për proçedurat e liçensimit e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008 në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e proçedurave të liçensimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 4.4.2007.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të filloj procedurat për liçensimin e shoqërisë “GEN –I TIRANA” sh.p.k,, për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta